



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 16 maj 2024
Nr. ref.: MM 2429/24

MENDIM MOSPAJTUES
i gjyqtarit Jeton Bytyqi, të cilit i është bashkuar gjyqtari Enver Peci

në

rastin nr. KI121/22

Parashtrues

Mexhid Asllani, Ekrem Asllani dhe Nuredin Xhaferi

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit [Rev. nr. 434/2021] të 24 majit
2022 të Gjykatës Supreme dhe të Aktgjykimit [Ac. nr. 1148/2018] të 4 marsit
2020 të Gjykatës së Apelit**

E respektojmë vendimin e Shumicës së Gjyqtarëve (në tekstin e mëtejme: Shumica) të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata). Megjithatë, gjithnjë me respekt, kemi votuar kundër pranueshmërisë së kërkesës dhe konstatimit të shkeljes së paragrafit 1 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në ndërlidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejta e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ). Prandaj, për arsyet që do të elaborohen në vijim dhe bazuar në rregullin 56 (Mendimet mospajtuese) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës), paraqesim këtë Mendim mospajtuës.

Fushëveprimi i kërkesës

- Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë kushtetutshmërinë e (i) Aktvendimit [Rev. nr. 434/2021] të 24 majit 2022 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) dhe kushtetutshmërinë e (ii) Aktgjykimit [Ac. nr. 1148/2018] të 4 marsit 2020 të Gjykatës së Apelit, në ndërlidhje me Aktgjykimin [C. nr. 395/2015] e 23 qershorit 2017 të Gjykatës Themelore në Ferizaj (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).
- Parashtruesit e kërkesës konsiderojnë se vendimet e lartcekura kanë shkelur të drejtat e tyre të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32

[E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe me nenin 6.1 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

3. Shumica vendosi (i) ta deklarojë kërkesën të pranueshme; (ii) të konstatojë se ka pasur shkelje të paragrafit 1 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së; (iii) ta shpallë të pavlefshëm Aktvendimin [Rev. nr. 434/2021] e 24 majit 2022, Aktgjykimin [Rev. nr. 426/2020] e 29 qershorit 2021 të Gjykatës Supreme dhe Aktgjykimin [Ac. nr. 1148/2018] e 4 marsit 2020 të Gjykatës së Apelit; dhe (iv) ta kthejë Aktgjykimin [Ac. nr. 1148/2018] e 4 marsit 2020 të Gjykatës së Apelit, në rivendosje pranë kësaj të fundit.

Faktet e rastit dhe pretendimet e parashtruesve

4. Faktet e rastit, ashtu siç janë të reflektuara edhe në Aktgjykimin në rastin KI121/22, ndërlidhen me një aksident në komunikacion në të cilin parashtruesit pësuan lëndime trupore, shkaktar i të cilit ishte i siguruari i të paditurës, Sigal Uniqua Group Austria. Parashtruesit e kërkesës, ndaj kompanisë në fjalë, kanë paraqitur padi në Gjykatën Themelore, nëpërmjet së cilës kërkuan kompensimin e dëmeve materiale dhe jomateriale për shkak të lëndimeve trupore dhe shpirtërore të pësuar nga aksidenti.
5. Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit [C. nr. 395/2015] kishte aprovuar pjesërisht padinë e parashtruesve të kërkesës dhe kishte detyruar të paditurën, Sigal Uniqua Group Austria, që t'ua paguajë atyre shumën e përgjithshme prej tetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e një euro (8,751.00) euro, ndërsa kishte refuzuar kërkesëpadinë për shumën prej shtatë mijë e tetëqind e katërdhjetë (7,840.00) euro, e cila e ndarë për secilin parashtrues nuk kalonte shumën prej tremijë (3,000.00) euro. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, (i) e paditura, Sigal Uniqua Group Austria; dhe (ii) parashtruesit e kërkesës, kishin paraqitur ankesa në Gjykatën e Apelit. Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 1148/2018] të 4 marsit 2020, kishte refuzuar ankesën e të paditurës, Sigal Uniqua Group Austria, duke konfirmuar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore. Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit të lartcekur, nuk kishte vendosur përkitazi me ankesën e parashtruesve të kërkesës.
6. Kundër Aktgjykimit [Ac. nr. 1148/2018] të 4 marsit 2020 të Gjykatës së Apelit (i), e paditura, Sigal Uniqua Group Austria; dhe (ii) parashtruesit e kërkesës, kishin paraqitur revizion në Gjykatën Supreme. Si rezultat i kësaj, Gjykata Supreme, (i) përmes Aktgjykimit [Rev. nr. 426/2020] të 29 qershorit 2021, kishte refuzuar revizionin e të paditurës, Sigal Uniqua Group. Ndërsa, (ii) pas kërkesës së parashtruesve të kërkesës për të marrë në shqyrtim revizionin e tyre, Gjykata Supreme, përmes Aktvendimit [Rev. nr. 434/2021] e plotësoi Aktgjykimin [Rev. 426/2020] e Gjykatës Supreme dhe vendosi ta hedhë poshtë si të palejuar revizionin e parashtruesve të kërkesës, bazuar në paragrafin 2 të nenit 211 dhe nenit 221 të Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejmes: LPK), me arsyetimin se vlera e kontestit e secilit parashtrues nuk kalonte shumën prej tremijë (3,000.00) euro.
7. Para Gjykatës, parashtruesit e kërkesës pretendojnë shkelje (i) të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së; (ii) të drejtës për mjete juridike të garantuar me nenin 32 të Kushtetutës; si dhe (iii) të drejtës për mbrojtje gjyqësore të të drejtave të garantuar me nenin 54 të Kushtetutës, ndër të tjera, pasi sipas tyre (i) Gjykata e Apelit nuk ka shqyrtuar ankesën e tyre kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore; ndërsa (ii) Gjykata Supreme nuk ka shqyrtuar në merita revizionin e tyre kundër Aktgjykimit [Ac. nr. 1148/2018] të 4 marsit

2020 të Gjykatës së Apelit, ku, ndër të tjera, ishte ngritur edhe çështja e mosshqyrtimit të ankesës së parashtruesve nga ana e Gjykatës së e Apelit.

Vërejtje preliminare

8. Siç u theksua më lart, Shumica ka konstatuar se vendimet kontestuarra janë nxjerrë në shkelje të paragrafit 1 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, me arsyetimin se Gjykata Supreme ka shkelur parimin e “*qasjes në gjykatë*” pasi e njëjta nuk ka vlerësuar pretendimin e parashtruesve të kërkesës se Gjykata e Apelit nuk ka vendosur për ankesën e parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, por ka hedhur poshtë revizionin si të palejuar për shkak se vlera e përcaktuar në Aktgjykimin e goditur të Gjykatës së Apelit përmes revizionit, nga secili parashtrues, nuk e ka kaluar shumën prej tremijë (3,000.00) euro, si kusht për të paraqitur revizion bazuar në nenin 211 të LPK-së.
9. Lidhur me këtë, për Shumicën, nuk ka qenë kontestuese që (ii) shumata monetare e goditur nga secili nga parashtruesit e kërkesës ndaj Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit është nën shumën prej tremijë (3,000.00) euro; dhe as (ii) mënyra e llogaritjes së vlerës së goditur si pasojë e bashkëndërgjyqjes së thjeshtë, ku pozita procedurale e një bashkëndërgjyqësi nuk varet nga pozita procedurale e bashkëndërgjyqësve tjerë, por merret veç e veç për çdo njërin prej tyre. Kontestuese, sipas Shumicës, ishte nëse përkundër faktit që shumata e goditura përmes revizionit nga secili nga parashtruesit e kërkesës është nën shumën prej tremijë (3,000.00) euro, Gjykata Supreme, duke refuzuar si të palejuar revizionin e parashtruesve të kërkesës kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, ka cenuar të drejtën e parashtruesve të kërkesës për “*qasje në gjykatë*” si pjesë përbërëse e një gjykimi të drejtë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së. Shumica ka arsyetuar se, pavarësisht kriterit të lejueshmërisë së vlerës së goditur përmes revizionit, Gjykata Supreme ka pasur për obligim që të trajtojë revizionin e parashtruesve të kërkesës, duke marrë parasysh që parashtruesit para saj kishin ngritur çështjen e mostrajtit të ankesës së tyre kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore nga ana e Gjykatës së Apelit.
10. Me respekt ndaj Shumicës, nuk mund të pajtohemi me konstatimet e lartcekura, pasi që konsiderojmë se këto konstatime nuk janë në pajtueshmëri me praktikën gjyqësore të Gjykatës dhe atë të GJEDNJ-së.

Përkitazi me kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [Rev. nr. 426/2020] dhe Aktvendimit [Rev. nr. 434/2021] të Gjykatës Supreme

11. Fillimisht, ashtu siç është theksuar edhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës, çështja e hedhjes poshtë të revizionit, për shkak se e njëjta nuk e arrin vlerën e përcaktuar me ligj, hyn në kuadër të së drejtës për “*qasje në gjykatë*”, si pjesë përbërëse e një gjykimi të drejtë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së (shih rastin e Gjykatës, [KI96/22](#), parashtrues *Naser Husaj dhe Uliks Husaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 29 gushtit 2023, paragrafi 49). Prandaj, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe të Gjykatës, e “*drejta në gjykatë*” përcakton që palët në procedurë duhet të kenë një mjet efektiv juridik që ua mundëson atyre mbrojtjen e të drejtave të tyre civile (shih rastet e lartcekura të Gjykatës [KI54/21](#), me parashtruesin e lartpërmendur *Kamber Hoxha*, paragrafi 62; [KI224/19](#), me parashtruesin e lartpërmendur *Islam Krasniqi*, paragrafi 35; dhe [KI20/21](#), me parashtruesin e lartcekur *Violeta Todorović*, paragrafi 41, shih në këtë kontekst dhe rastet e lartcekura

të GJEDNJ-së, [Bëlesh dhe të tjerët kundër Republikës Çeke](#), paragrafi 49, dhe rastin e lartcekur [Nait-Liman kundër Zvicrës](#), paragrafi 112).

12. Megjithatë, e drejta për “*qasje në gjykatë*” nuk është absolute, por mund t’i nënshtrohet kufizimeve, pasi që nga vetë natyra e saj kërkon rregullim nga shteti, i cili gëzon një liri të caktuar vlerësimi në këtë drejtim (shih në lidhje me këtë rastin e lartcekur të Gjykatës KI54/21, paragrafi 64; KI20/21, cituar më lart, paragrafi 44). Në këtë kontest, çdo kufizim i të drejtës së qasjes në gjykatë nuk duhet të kufizojë ose zvogëlojë qasjen e një personi në atë mënyrë apo në një masë të tillë që të dëmtohet vetë thelbi i “*së drejtës në gjykatë*”. Kufizimet e tilla nuk do të jenë të pajtueshme nëse ato nuk ndjekin një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një raport i arsyeshëm i proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që dëshirohet të arrihet (shih rastin e lartcekur të Gjykatës KI 20/21, cituar më lart, paragrafi 45, dhe rastet e GJEDNJ-së: [Sotiris dhe Nikos Koutras ATTEE kundër Greqisë](#), Aktgjykim i 16 nëntorit 2000, paragrafi 15, dhe [Bëlesh dhe të tjerët kundër Republikës Çeke](#), Aktgjykim i 12 nëntorit 2002, paragrafi 61).
13. Në këtë kontekst, dhe më specifiku ndërlidhur me pragun ligjor *ratione valoris*, GJEDNJ, përmes praktikës së saj gjyqësore, ka theksuar se kjo e fundit “*ka pranuar më tej se aplikimi i një pragu ligjor ratione valoris për ankesat në gjykatën supreme është një kërkesë procedurale legjitime dhe e arsyeshme duke pasur parasysh thelbin e rolit të gjykatës supreme për t’u marrë vetëm me çështje të rëndësisë së nevojshme*” (shih rastin e GJEDNJ-së [Zubac Kundër Kroacisë](#) nr. 40160/12, Aktgjykim i 5 prillit 2018, paragrafi 83, dhe rastet e cituara aty).
14. Gjithashtu, GJEDNJ ka sqaruar se “*bazuar në praktikën në lidhje me zbatimin e kufizimeve ligjore ratione valoris për qasje në gjykatat e larta, Gjykata duhet në shkallë të ndryshme të marrë parasysh disa faktorë të mëtejshëm, përkatësisht (i) parashikueshmërinë e kufizimit, (ii) nëse është parashtruesi i kërkesës ose shteti i paditur ai i cili duhet të bartë pasojat negative të gabimeve të bëra gjatë procedurës që çuan në mohimin e qasjes së parashtrueses së kërkesës në gjykatën supreme dhe (iii) nëse mund të thuhet se kufizimet në fjalë përfshijnë “formalizëm të tepruar”* (shih, rastin [Zubac kundër Kroacisë](#), paragrafi 85, dhe rastet e cituara aty).
15. Prandaj, siç rezulton nga parimet e GJEDNJ-së, në parim, kushtëzimi i një mjete juridik në nivel të Gjykatës Supreme me një vlerë të caktuar, nga pikëpamja e të drejtës për një gjykim të drejtë, është i lejuar dhe legjitim duke pasur parasysh edhe thelbin e rolit të gjykatave më të larta për t’u marrë vetëm me çështje të rëndësisë së nevojshme, dhe duhet të plotësojë kriteret e lartcekura të përcaktuara në praktikë gjyqësore të GJEDNJ-së.
16. Në rastin konkret, Gjykata Supreme, përmes vendimit të kontestuar, kishte vendosur që revizioni i parashtruesve të kërkesës është i palejuar me arsyetimin se vlera e kontestit e secilit parashtrues veç e veç, bazuar në bashkëndërgjyësinë e thjeshtë, nuk kalonte shumë prej tremijë (3,000.00) euro. Gjykata Supreme e kishte bazuar vendimin e saj në paragrafin 2 të nenit 211 dhe nenit 221 të LPK-së. Më konkretisht, neni 211 i LPK-së përcakton kriteret për lejueshmërinë e revizionit duke saktësuar se: “*Revizioni nuk lejohet në kontestet pasurore-juridike në të cilat kërkesëpadia ka të bëjë me kërkesat në të holla, me dorëzimin e sendit, ose me përmbushjen e ndonjë premtimi tjetër, po që se vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit nuk i kalon 3.000 Euro*”.
17. Përjashtimisht, paragrafi 4 i nenit 211 të LPK-së përcakton një listë shteruese se kur revizioni është gjithmonë i lejuar, dhe atë përkitazi me (a) kontestet për ushqim; (b)

kontestet për shpërblimin e dëmit për ushqimin e humbur, për shkak të vdekjes së dhënësit të ushqimit; dhe (c) kontestet nga marrëdhëniet e punës të cilat i fillon i punësuar kundër vendimit për shuarjen e marrëdhënies së punës. Rrjedhimisht, përkitazi me çështjet e lartcekura, revizioni është gjithmonë i lejuar, pavarësisht vlerës së kontestit, gjë që në rastin konkret, ky nuk ishte rasti.

18. Lidhur me këtë, përderisa neni 211 i LPK-së përcakton kriteret për lejueshmërinë e revizionit, neni 214 i LPK-së (i ndryshuar dhe plotësuar përmes Ligjit 04/L-118), përcakton shkaqet lidhur me të cilat mund të paraqitet revizioni.
19. Rrjedhimisht, nëse revizion i paraqitur është i lejuar, përfshirë nëse shuma e kontestit është mbi tremijë (3,000.00) euro dhe kur kjo është e zbatueshme, bazuar në kriteret e lejueshmërisë të përcaktuara në nenin 211 të LPK-së, atëherë i njëjti shqyrtohet bazuar në nenin 214 të Ligjit të lartcekur dhe shkaqet e përcaktuara në këtë nen. Nga kjo rezulton se shkaqet e revizionit të përcaktuara në nenin 214 të LPK-së mund të shqyrtohen vetëm atëherë kur Gjykata Supreme ka konstatuar lejueshmërinë e revizionit ashtu siç përcaktohet në nenin 211 të këtij Ligji. Rrjedhimisht, edhe në rastin konkret, Gjykata Supreme, duke vlerësuar se asnjëri nga parashtruesit e kërkesës nuk kishte kaluar pragun prej tremijë (3,000.00) eurove, kishte konstatuar dhe për pasojë kishte vendosur që revizioni nuk ishte i lejuar ashtu siç përcaktohet në nenin 211 të LPK-së.
20. Bazuar në si më lart, konsiderojmë se ky konstatim i Gjykatës Supreme është në harmoni me praktikën tashmë të konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese në një numër rastesh para saj kur kishte vlerësuar përkitazi me çështjen e lejueshmërisë së revizionit para Gjykatës Supreme si rezultat i mos përmbushjes së pragut të vlerës së kontestit. Në këtë kontekst, i referohemi rastit të Gjykatës [KI199/18](#), Aktvendim për papranueshmëri i 6 qershorit 2019, përkatësisht paragrafit 38, ku Gjykata ka theksuar se *“Praktika gjyqësore e kësaj Gjykate tregon se ka pasur edhe raste të tjera kur është kontestuar një aktvendim i Gjykatës Supreme – sikurse ky i tanishmi - përmes së cilit ish-in refuzuar si të palejuara kërkesat për revizion në të cilat vlera e kontestit ishte nën 3,000 euro. Në rastet e tilla Gjykata, sikurse në rastin e tanishëm, është fokusuar vetëm në atë se, në tërësi, a kanë përfutur parashtruesit përkatës nga një gjykim i drejtë dhe i paanshëm duke mos u lëshuar në çështje të ligjshmërisë dhe aspekteve të interpretimit të ligjit procedural dhe material duke qenë se ingjencat e tilla janë nën juridiksionin primar të gjykatave të rregullta. Rastet e tilla, Gjykata i ka shpallur të papranueshme si qartazi të pabazuara. (Shih, rastet e Gjykatës Kushtetuese ku është kontestuar një vendim i Gjykatës Supreme që kërkesën për revizion e ka refuzuar në baza procedurale si të palejueshëm: [KI66/18](#) parashtrues Sahit Muçolli, Aktvendim i 6 dhjetorit 2018; [KI110/16](#) parashtrues Nebojsa Dokić, Aktvendim i 24 marsit 2017; [KI24/16](#) parashtrues Avdi Haziri, Aktvendim i 4 nëntorit 2016; [KI112/14](#) parashtrues Srboljub Krstić, Aktvendim i 19 janarit 2015; [KI84/13](#) parashtrues Gani, Ahmet dhe Nazmije Sopaj, Aktvendim i 18 nëntorit 2013).”*
21. Prandaj, konsiderojmë se edhe në rastin konkret, Gjykata Supreme, duke zbatuar paragrafin 2 të nenit 211 të LPK-së, duke vendosur përkitazi me juridiksionin e saj të përcaktuar me ligj, ka vendosur se revizioni i parashtruesve të kërkesës është i palejuar sepse vlera e goditur nga Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit për secilin parashtrues nuk e kalon vlerën prej tremijë (3,000.00) euro për secilin parashtrues të kërkesës. Për më tepër, nuk është argumentuar nga parashtruesit e kërkesës se ky kufizim ligjor *ratione valoris* për qasje në Gjykatën Supreme, dhe bazuar në kriteret e përcaktuara në praktikë gjyqësore të GJEDNJ-së, përfshirë rastin *Zubac kundër Kroacisë*, cituar më lart: (i) nuk është i parashikueshëm; (ii) parashtruesit e kërkesës kanë bartë pasojat negative të

gabimeve gjatë procedurës që çuan në mohimin e qasjes së parashtrueses së kërkesës në Gjykatën Supreme; dhe se (iii) interpretimi i Gjykatës Supreme rezulton në “formalizëm të tepruar”.

22. Gjithashtu, është më rëndësi të theksohet se sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe asaj të Gjykatës, rregullat që përcaktojnë hapat procedural që kërkohet të ndërmerren dhe afatet kohore të cilat duhet të respektohen sa i përket paraqitjes së ankesës janë krijuar për të siguruar administrimin e duhur të drejtësisë dhe pajtueshmërinë, veçanërisht, me parimin e sigurisë juridike (shih rastin e Gjykatës, KI210/19, Aktvendim për papranueshmëri i Gjykatës i 15 korrikut 2020, paragrafi 37; dhe rastin e GJEDNJ [Ben Salah Adraqui and Dhaima kundër Spanjës](#), nr. 45023/98, Vendim i 27 prillit 2000).
23. Prandaj, konsiderojmë se gjykatat e rregullta kanë për obligim që të respektojnë juridiksionit të tyre të përcaktuar me Kushtetutë e ligj. Në të kundërtën, çështja e tejkallimit të juridiksionit të një gjykate, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës, ngrit çështje të së drejtës së “gjykatës së themeluar me ligj”, si pjesë përbërëse e një gjykimi të drejtë. Lidhur me këtë, i referohem rastit të Gjykatës që ka theksuar se ky parim cenohet, ndër të tjera, nëse një gjykatë ka vendosur jashtë juridiksionit të saj (shih rastin e Gjykatës [KI14/22](#), parashtrues Shpresa Gërvalla, Aktgjykim i 23 shkurtit 2023, paragrafi 58 si dhe rastet [Cowme dhe të tjerët kundër Belgjikës](#), nr. 32492/96 dhe katër të tjerë, Aktgjykim i 22 qershorit 2000, paragrafët 107-109 dhe [Sokurenko and Strugun kundër Ukrainës](#), nr. 29458/04 dhe 29465/04, Aktgjykim i 20 korrikut 2006, paragrafët 26-28);
24. Për më tepër, Gjykata përmes Aktgjykimit të saj në rastin [KI214/19](#), me parashtrues *Murteza Koka*, ka konstatuar shkelje të së drejtës së parashtruesit të kërkesës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës si rezultat i vendimit të Gjykatës Supreme, përmes të cilit ishte rihapur rasti i parashtruesit të kërkesës i vendosur me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, e cila kishte vërtetuar Aktgjykimin të Gjykatës Themelore dhe të cilat ishin bërë *res-judicata*, pikërisht duke pasur parasysh vlerën e kontestit e cila sipas vendimeve gjyqësore ishte nën shumën për të cilën është i lejuar revizioni, përkatësisht nën shumën prej tremijë (3,000.00) euro, ndërsa vlera e objektit të kontestit me asnjë vendim të gjykatave të rregullta nuk ishte kontestuar dhe korigjuar (shih rastin e Gjykatës KI214/19, parashtrues *Murteza Koka*, Aktgjykim i 29 korrikut 2020).
25. Thënë këtë, nëse Gjykata Supreme do të anashkalonte kërkesat ligjore përkitazi me vlerën e shumës së goditur me revizion, siç janë përcaktuar në nenin 211 të LPK-së, do të tejkalonte juridiksionin e saj të përcaktuar me këtë ligj, e që kjo do të rezultonte në shkelje të së drejtës për një gjykim të drejtë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.
26. Bazuar në të lartcekurat, konsiderojmë se kërkesa e parashtruesve të kërkesës sa i përket (i) Aktvendimit [Rev. nr. 434/2021] të 24 majit 2022 të Gjykatës Supreme është qartazi i pabazuar, ashtu siç përcaktohet në paragrafin 2 të rregullit 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës.

Përkitazi me kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [Ac. nr. 1148/2018] të 4 marsit 2020 të Gjykatës së Apelit

27. Përkitazi me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, qëndron fakti se parashtruesit e kërkesës kanë pasur një pretendim legjitim, që ndërlihet me mostrajtimin e ankesës së tyre nga Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit të saj [Ac. nr. 1148/2018] të 4 marsit 2020, gjë që ngrit çështjen e të drejtës për “qasjen në drejtësi” të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.
28. Megjithatë, konsiderojmë se parashtruesit e kërkesës kanë pasur në dispozicion mjete juridike për të sfiduar Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit para Gjykatës Kushtetuese përmes kërkesës individuale të përcaktuar në paragrafin 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës.
29. Kjo pasi, së pari parashtruesve të kërkesës, ashtu siç qëndron praktika gjyqësore e Gjykatës momentalisht, nuk i'u kërkohet që pas marrjes së vendimit nga Gjykata e Apelit, të shterin mjete juridike të jashtëzakonshme siç është rasti me revizionin, në mënyrë që t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese (shih rastin e Gjykatës [KI24/20](#), parashtrues “Pamex SH.P.K”, Aktgjykim i 3 shkurtit 2021).
30. Së dyti, pavarësisht të lartcekurave, Gjykata ka sqaruar, përmes praktikës së saj gjyqësore, se në rastet kur mjeti i jashtëzakonshëm juridik i revizionit në Gjykatën Supreme është i palejuar bazuar në ligjin e aplikueshëm, i njëjti nuk mund të përdoret për qëllime të llogaritjes së afatit katër (4) mujor dhe që si “vendim përfundimtar” duhet të llogaritet vendimi i gjykatës përkatëse kundër të cilit është paraqitur mjeti i jashtëzakonshëm juridik i revizionit dhe i cili kontestohet para Gjykatës. Prandaj, këto rrethana, në parim përfshijnë rastet kur është përdorur mjeti i jashtëzakonshëm juridik i revizionit në Gjykatën Supreme, përkundër që nuk është i lejuar bazuar në nenet 211 të LPK-së, përfshirë në rast kur vlera e kontestit është nën shumën tremijë (3,000.00) euro (shih rastin e Gjykatës [KI118/20](#) me parashtrues *Selim Leka*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 21 tetorit 2021, paragrafët 44-48). Rrjedhimisht, në rastin lartcekur, Gjykata e kishte shpallur kërkesën si të pasafatshme.
31. Thënë këtë, pas pranimit të Aktgjykimit [Ac. nr. 1148/2018] të 4 marsit 2020 të Gjykatës së Apelit, parashtruesit e kërkesës asgjë nuk i ka ndaluar që t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese. Megjithatë, ata kanë përdorur mjetin juridik të revizionit kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, të vetëdijshëm se vlera e goditur për secilin parashtrues është nën vlerën prej tremijë (3,000.00) euro, që ka rezultuar që revizioni i tyre të hedhet poshtë si i palejuar.
32. Rrjedhimisht, konsiderojmë se si “vendim i fundit”, sipas nenit 49 të Ligjit është Aktvendimi [Ac. nr. 1148/2018] i Gjykatës së Apeli i 4 marsit 2020, dhe i cili bazuar në rrethanat e rastit, konsiderojmë se është paraqitur para Gjykatës jashtë afatit katër (4) mujor të përcaktuar me nenin 49 (Afati) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe paragrafin 1 (c) të Rregullit 34 të Rregullores së punës.

Dorëzuan me respekt:

Gjyqtari Jeton Bytyqi



Gjyqtari Enver Peci